



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1948/9 prot.

Datë 02.09.2026

V E N D I M
Nr.1098/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.09.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M sh.p.k në procedurën e prokurimit “E hapur,” me REF-80711-04-01-2026, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Valias, Grupi 1”, me fond limit 172,262,930.82 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M me NIPT L78223801E dhe L88419801O dhe adresë Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati i I, Zona kadastrale 1090, mallakastër, Ballsh.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamez
Adresa : Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit *“E hapur,”* me REF-80711-04-01-2026, me objekt: *“Ndërtim Rrugët Blloku Valias, Grupi 1”*, me fond limit 172,262,930.82 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 29.05.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor më datë 15.06.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Company Riviera 2008	90.715.737,00 lekë	Kualifikuar
Shendelli	95.762.082,00 lekë	Kualifikuar
L.T.E Construction	95.890.656,54 lekë	Kualifikuar
Liqeni VII	99.452.651,78 lekë	Kualifikuar
BOE Korabi 2007&Kronos Konstruksion	99.680.114,51 lekë	Kualifikuar
Almo Konstruksion	107.474.266,00 lekë	Kualifikuar
BOE KlajgerKonstruksion &Vellezerit Hysa	107.667.019,61 lekë	Kualifikuar
BOE Be-Is& 2 T	111.778.148,00 lekë	Kualifikuar
Ndregjoni	115.870.813,00 lekë	Kualifikuar
BOE B93 II &Elmazaj Konstruksion&Grama	116.370.652,07 lekë	Kualifikuar
BOE Lis Konstruksion&Kegli-Duri &Viante Konstruksion	105,917,896 lekë	Skualifikuar
BOE K.M.K &Caushi M	103,238,361 lekë	Skualifikuar
BOE 2 N dhe Avduli	106,000,004 lekë	Skualifikuar
BOE Em-Ea Construction &Agri Construction & Pro Green	97,970,451 lekë	Skualifikuar

II.4 Në datën 16.06.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 18.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6842 dhe me nr. 1948/2026 prot., datë 18.06.2026 e operatorit ekonomik “BOE K.M.K & Caushi M ” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M sh.p.k nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1948/1 prot, datë 18.06.2026.

II.7 Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 6949/1 prot., datë 23.06.2026, protokolluar me tonën me nr.1948/2 prot., datë 23.06.2026, ka dërguar vendimin e KSHA nr.6949 prot, datë 23.06.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar: [...] *Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, u konstatua se ankesa nuk plotëson kërkesat formale dhe procedurale të përcaktuara në nenin 94 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për shkak të mungesës së elementeve dhe dokumentacionit të domosdoshëm për vijimin e shqyrtimit administrativ të saj.*

Përgjat këtij afati nuk janë depozituar pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacioni plotësues dhe sqarimet e nevojshme për rregullimin e mangësive të konstatuara. Mungesa e plotësimit të elementëve thelbësore procedurale e bën të pamundur vijimin e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës në themel, pasi respektimi i kriterëve formale përbën kusht të domosdoshëm për marrjen në shqyrtim të saj.

Sa më sipër,

Në kushtet kur ankimuesi nuk ka përmbushur detyrimin procedural për korrigjimin e mangësive të evidentuara brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 94 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ankesa me nr. aplikimi online A/2026/6842, datë 18.06.2026, nuk merret në shqyrtim.[...].

II.8 Me shkresën nr.1948/3 prot., datë 10.08.2026, me objekt “Kërkesë për informacion.” Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: “[...] Me shkresën nr.6949/1 prot., datë 23.06.2026, protokolluar me tonën me nr.1948/2 prot., datë 26.06.2026, autoriteti kontraktor njofton se ka shqyrtur ankesën e operatorit ekonomik ankimues, BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M sh.p.k dhe në përfundim ka vendosur të mos e marrë në shqyrtim ankesën me arsyetimin se, nuk janë korrigjuar mangësitë e konstatuara.

Bazuar në nenin 111, pika 3 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kërkojmë të na informoni për sa më poshtë:

- 1. A e keni njoftuar BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M sh.p.k për korrigjimin e të metave të ankesës? Nëse po, lutemi të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.[...].*

II.9. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.6949/3 prot., datë 17.08.2026 me objekt “Kthim përgjigje”, protokolluar me tonën me nr.1948/4 prot., datë 20.08.2026, informon Komisionin e Prokurimit Publik si më poshtë:

“Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 1948/3 prot., datë 10.08.2026, administruar pranë Bashkisë Kamëz me nr. 6949/2 prot., datë 17.08.2026, me lëndë: "Kërkesë për informacion", në lidhje me njoftimin e BOE "K.M.K" SHPK & "Caushi-M" SHPK për korrigjimin e të metave të ankesës, në lidhje me procedurën e prokurimit "E hapur", me REF-80711-04-01-2026, me objekt: "Ndërtim Rrugët Blloku Valias, Grupi 1", me fond limit: 172,262,930.82 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.05.2026 nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kamëz

Për sa më sipër, ju njoftojmë se nisur nga fakti që pagesa nuk u reflektua brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e pagesës, Autoriteti Kontraktor nuk e ka vlerësuar të arsyeshme të kërkojë plotësimin e të metave të konstatuara. Për më tepër, tarifa përkatëse e ankesës vijon të jetë e papaguar”.

II.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur ankesës së mësipërme konstatohet, se formulari i ankesës së dorëzuar është me të meta, pasi mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

II.11 Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pagesën e tarifës financiare, KPP iu drejtua me kërkesën nr.1948/5 prot., datë 01.09.2026 Drejtorisë së Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë KPP-së për informacion mbi pagesën e tarifës financiare të kryer nga operatori ekonomik BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M. për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.12 Me shkresën Nr 1948/6 datë 01.09.2026, lidhur me kërkesën e bërë për statusin e ankesës së operatorit ekonomik “BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M, sektori i Financës së KPP informoi se nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është kryer pagesë lidhur me ankesën e paraqitur

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik në datë 18.06.2026 me nr. 1948 prot., nga operatori ekonomik BOE K.M.K SHPK & Caushi-M. SHPK, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”

III.1.2. Autoriteti kontraktor me shkresën 5529/1 prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1485/3 datë 25.05.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e KSHA nr. 5529 prot., datë 21.05.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA-së, Nr.5529 prot., datë 21.05.2026, rezulton se kjo e fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj, për shkak të moskryerjes së pagesës nga operatori ekonomik ankimues.

III.1.3. Referuar pikës 2, të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Sa më sipër, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës, Komisioni gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M sh.p.k nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj, bazuar në gërmën “a”, të pikës 2, të nenit 118, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kjo ankesë duhet refuzuar.

III.2.Në lidhje me mosveprimin e autoritetit kontraktor për njoftimin e operatorit ekonomik ankimues BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M sh.p.k për korigjimin e të metave të ankesës, referuar pikës 3, të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2, të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit të subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës. Referuar shkresës nr. 6949/3 prot., datë 17.08.2026 , protokolluar me tonën me nr. 1948/4 prot. datë 20.08.2026 , rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3, të nenit 111 të LPP-së, duke mos respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, duke mos i kërkuar operatorit ekonomik ankimues ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret, kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e kryer nga ky i fundit.

Komisioni i Prokurimit Publik, thekson faktin se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga shqyrtimi i dokumenteve standarde të tenderit, përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.2.1 Për sa më sipër Komisioni gjykon, se duke qenë se Autoriteti Kontraktor nuk ka zbatuar parashikimet ligjore të sipërcituara konsiderohet se ka kryer shkelje procedurale të cilat vijnë në kundërshtim me pikën 3, të nenit 113, të ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar sipas të cilit parashikohet se: *3.Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.* Duke marrë shkas nga përgjigja e autoritetit kontraktor referuar shkresës nr. 6949/3 prot., datë 17.08.2026 , protokolluar me tonën me nr. 1948/4 prot. datë 20.08.2026 dhe nga verifikimi i sitemit elektronik të

prokurimeve, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, pasi nuk i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues korigjimin e të metave të ankesës, sikurse është pagesa e tarifës për ankesën e bërë. Komisioni i Prokurimit Publik i ndodhur para një situatë të tillë, gjykon, se veprimet e ndërmarra nga Autoriteti Kontraktor, duke vijuar me shqyrtimin e ankesës pa i kërkuar më parë operatorit ekonomik korigjimin e të metave të saj, nuk janë në përputhje me parashikimet ligjore që kërkojnë nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik. Për rrjedhojë, Komisioni i tërheq vëmendjen Autoritetit Kontraktor për respektimin e plotë dhe rigoroz të detyrimeve ligjore që lidhen me zhvillimin e procedurave të prokurimit, garantimin e konkurrencës së ndershme, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë dhe mbrojtjen e interesit publik. Njëkohësisht, nisur nga shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, Komisioni çmon të nevojshme që propozojë APP të iniciojë një verifikim administrativ të veprimtarisë së personave përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit, përfshirë anëtarët e njësisë së prokurimit dhe strukturat e përfshira në procesin e vlerësimit dhe vendimmarrjes, me qëllim evidentimin e përgjegjësiave disiplinore apo administrative të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në rast se konstatohen shkelje të detyrimeve funksionale.

III.2.2. Për sa më sipër parashtruar, Komisioni i Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 23 pika e) të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ për të gjithë zyrtarët përgjegjës për shkeljet e konstatuara.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2024, datë 13.10.2024 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik BOE K.M.K sh.p.k & Caushi-M sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-80711-04-01-2026, me objekt: “Ndërtim Rrugët Blloku Valias, Grupi 1”, me fond limit 172,262,930.82 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

3. T'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e ankimit elektronik nr. A/2026/6842, datë 18.06.2026 dhe nr. 1948/2026 prot., protokolluar me tonën me datë. 18.06.2026.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Nertil Kanina

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Kryetar
Ismail Shehu



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date: 2026/09/02 15:41:01 +02'00'
6393f57d890c49849c757307a33cd8df20260902154057
83020

Digitally signed by
Ismail Shehu
Date: 2026.09.02
03:45:13